



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 25/15, DATË 06 / 06 / 2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 25/5, DATË 15/12/2020
TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE “PËR SHTYRJEN E
AFATIT TË STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E
VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT ME POTENCIAL STRATEGJIK
“SAN PIETRO”**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 18 dhe 22 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu II, pika 8 të VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, si dhe bazuar në Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 25/2, datë 20/11/2017 “Për miratimin e statusit strategjik ‘investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë’ për projektin e investimit strategjik San Pietro” dhe Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 25/5 datë 15.12.2020, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendimin Nr. 25/2, datë 20/11/2017, ka vendosur miratimin e statusit strategjik për projektin “San Pietro”, me subjekt “Concord Investment shpk”, me NIUS/NIPT K81602049K, për realizimin e një kompleksi elitar turistik, në zonën më veriore të Gjirit të Lalzit. Projekti është i ndarë në dy hapësira të mëdha: hoteleri me 5 yje, me 500 dhoma dhe fshat turistik e ambiente shërbimi.
- Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendimin Nr. 25/5, datë 15/12/2020, ka miratuar shtypjen e afatit të statusit, duke i miratuar edhe masat mbështetëse, sipas legjislacionit në fuqi.
- Subjekti investues është i pajisur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.13, datë 28.02.2020 “Për miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.16, datë 27.04.2018, për objektin 'Ndërtimi i kompleksit turistik San Pietro, Komuna Ishëm, Qarku Durrës’.
- Subjekti investues gëzon statusin e veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special”, miratuar me VKM Nr. 300, datë 10.5.2019 "Për dhënien e statusit të veçantë “Investitor në Strukturë Akomoduese me 5 yje, Status Special”, aplikuesit “Concord Investment” shpk”.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 25/5, datë 15/12/2020 të Komitetit të Investimeve Strategjike, bëhen shtesat dhe ndryshimet siç vijon:
 - 1.1. Kudo, në vendim, fjalët “me vendim Nr. 7/1 Prot, datë 05.12.2016 “zëvendësohen me fjalët “me vendim Nr. 25/2, datë 20/11/2017”.
 - 1.2. Në fund të Nenit 1 shtohen fjalët “duke filluar nga data e njoftimit të këtij vendimi”.
 - 1.3. Neni 2, pika c, ndryshon si më poshtë vijon:

“c. Miratohet në parim masa mbështetëse e së drejtës së përdorimit të brigjeve dhe zonës përkatëse të plazhit përballë projektit të investimit strategjik sipas koordinatave në Aneks 1 i këtij vendimi, me një afat 30 (tridhjetë) vjeçar, pasi të jenë konfirmuar këto koordinata nga institucionet e përfshira në vlerësim.

Miratimi përfundimtar, si dhe mënyra, afatet, kostot e lejitimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit në funksion të realizimit të projektit investues strategjik do të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
 - 1.4. Në Nenin 5, fjalët “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”.
2. Ky vendim publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet investitorit.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT
ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
SOKOL NANO